



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj.16931/ 2010

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, përmes Gjyqtarës **Salihe Berisha – Ahmetaj** me sekretarin juridik Naim Thaqi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Lulzim Halit Kurtaj nga Prishtina, Ulpiana U 1 H. 2 ,nr.7 për shkak të kundërvajtjes nga neni 16.1.1 , e në lidhje me nenin 6.2. të Ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe te dhuratave te zyrtarve te larte publike, në bazë të nenit 37 , 195 , të Ligjit mbi kundërvajtjet, më datën 05.07.2010, harton këtë

A K T V E N D I M

I pandehuri **Lulzim Halil Kurtaj** i lindur më 05.12.1962 në Pejë me profesion ing. I elektroteknikes, I punesuar si menagjer I Telekomunikacionit ,gjegjisht anetar I Bordit ne Autoritetin Rregullator te Telekomunikacionit,të kryer fakultetin,I martuar ,I gjendjes së mesme ekonomike I pa dënuar më parë për kundërvajtje ,huk është nën hetime,, me vendbanim në Prishtinë Lagj. Ulpiana U1 H 2,nr7.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S E

Sepse nuk ka deklaruar pasurine ,per vitin 2009 ne Agjensionin kunder Korrupsionit ne Prishtine deri me daten 31.03.2010. - me çka i pandehuri ka kryer kundërvajtjen nga neni 16.1.1 , e në lidhje me nenin 6.2. të Ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe te dhuratave te zyrtarve te larte publike, andaj në bazë të dispozitave të të njejtit Ligj

D Ë N O H E T

ME DËNIM NË TË HOLLA në shumen prej **900 €**, të cilin denim e pandehura është e obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, e nëse pagesen nuk e bën në afatin e cekur, dënimi me të holla ka për t'iu zëvendësuar më denim burgu në kohëzgjatje prej **30 ditësh**, duke llogaritur një ditë burgu me **15 €**.

Obligohet e pandehura që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **5 €**, në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë të këtij aktvendimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Dënimin dhe paushallin gjyqësor e pandehura e paguan në këtë gjykatë.

Me nga një kopje të Aktvendimit të njoftohen i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia kunder Korrupsionit, me kërkesën nr.01/2290/10,të dates 15.06 2010 ka propozuar që kundër të pandehurit, të zhvillohet procedura kundërvajtëse, të shpallët përgjegjës dhe të ndëshkohet në bazë të Ligjit, për shkak të kundërvajtjes të përshkruar në dispozitiv.

Sipas kërkesës së parashtruar është zhvilluar procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Lulzim Halit Kurtaj ,i cili mbrojtjen e paraqitur pranë kësaj gjykate pranon të dhënat nga kërkesa se ka kryer kundërvajtjen që I vihet në barrë sipas kërkesës se para dates 31.03.2010. nga Agjencia kunder Korrupsionit e ka pranuar formularin per ta deklaruar pasurine por kete veprim nuk e ka bere,gjegjisht nuk e ka deklaruar pasurine per shkak te obligimeve te medha ne pune por edhe nga neglizhenca.

Pas shpjellimit të provave gjatë procedurës, shqimit të të dhënave në kërkesë dhe deklarates së të pandehurit gjykatësja ka fituar bindjen e lirë se i pandehuri është përgjegjës për kundërvajtjen e sanksionuar sipas nenit 16.1.1 , e në lidhje me nenin 6.2. të Ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe te dhuratave te zyrtarve te larte publike, Sepse nuk ka deklaruar pasurine ,per vitin 2009 ne Agjensionin kunder Korrupsionit ne Prishtine deri me daten 31.03.2010. prandaj duke marr parasysh tëra rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në shqiptimin e drejtë të dënimit Ligjor, duke pasur parasysh se dënimi i shqiptuar do të ndikoi pozitivisht që në të ardhmen mos të kryej kundërvajtje të tillë apo të ngjajshme, i shqiptoi dënimin me të holla, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 109 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Nr. 16931/ 2010 të dates 05.07.2010

GJYKATËSJA

Salihe Berisha – Ahmetaj

UDHËZIME MBI MJETIN JURIDIK Kundër këtij aktvendimi të drejtë ankese kanë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës , Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë,në afat prej 8 ditësh. nga dita e pranimit të këtij aktvendimi përmes kësaj gjykate ,pa pulla.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
Dep. _____
Dep. _____

Nr. i faq. _____
Broj stranica _____
Nr. pages _____

Nr. 0.01 _____
Priloz _____
Prot. No. **03/2555/10**
Data _____
Datum **08.07.2010**
Date _____

PRISHTINE